



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



ZYRA E PROKURIMIT

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i AK-së në bazë të Nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke vendosur sipas Kërkesës së Parashtruar për Rishqyrtim të dt. 23.02.2021 nga Operatori Ekonomik “N.T.P “BLETMIRI”, lidhur me Aktivitetin e Prokurimit “**Furnizim me shoqëri bletësh dhe koshere**” me Nr. të prokurimit 615-21-215-1-2-1, nxjerrë këtë:

VENDIM

1. **Refuzohet** Kërkesa për Rishqyrtim e parashtruar nga Operatori Ekonomik “N.T.P “BLETMIRI” me date 23.02.2021, lidhur me Aktivitetin e Prokurimit “**Furnizim me shoqëri bletësh dhe koshere**” me Nr. të prokurimit 615-21-215-1-2-1 kundër Njoftimit për kontrate të shpallur nga Autoritetit kontraktues me datë 28.01.2021. në ueb-faqe të KRPP-ës.
2. **Vërtetohet Njoftimi për kontrate** i shpallur nga Autoritetit kontraktues me datë 28.01.2021. në ueb-faqe të KRPP-ës.
3. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdojë me hapat e me tutjeshem sipas LPP-ës dhe legjislacionit dytësor të Prokurimit Publik.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike të e-prokurimit në ueb-faqen: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetimi

Operatori Ekonomik “N.T.P “BLETMIRI” me date 23.02.2021, ka parashtruar kërkesë për Rishqyrtim lidhur me Aktivitetin e Prokurimit “**Furnizim me shoqëri bletësh dhe koshere**” me Nr. të prokurimit 615-21-215-1-2-1. Autoriteti Kontraktues me date 25.02.2021. ka shqyrtuar kërkesën në fjale dhe ka ardhur në përfundim si në vijim:

Pas analizimit të pretendimit ankimore AK ka konstatuar se kërkesa për rishqyrtim është e pabazuar për arsye se pikat ankimore nuk qëndrojnë:

Operatori Ekonomik ne kërkesën për Rishqyrtim ka pretenduar se Autoriteti Kontraktues ka shkelur nenet ne vijim: Paragrafin 1 te nenit 1 te LPP-ës, paragrafin 2 te nenit 6 te LPP-ës Paragrafët 1 dhe 4 te nenit 7 te LPP-ës, si dhe nenet 10, 16, 28 dhe 69 te LPP-ës **pa përshkruar rrethanat faktike qe përbejnë supozimin për shkeljen e dispozitave te larte përmendura.**

E vetmja pike ankimore nga OE i lartpërmendur qe është përshkruar ne këtë rast eshtë neni 16 (vlere e parashikuar) i LPP-ës, mirëpo as kjo pike nuk qëndron ngase Autoriteti Kontraktues ne përlllogaritjen e vlerës se parashikuar është bazuar ne furnizimet e me hershme me shoqëri bletësh, dhe se për vet faktin se kjo është vetëm vlere e parashikuar nuk do të thotë që ofertat nuk e tejkalojnë parashikimin e Autoritetit Kontraktues.

Nga se u cek, në bazë të Ligjit nr. 04/L-042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin 05/I-092, zyrtari përgjegjës i prokurimit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Udhëzim juridik: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqes ankesë në OSHP.

Nr. 1437/01-0018803/21
Podujevë,
25.02.2021



u.d. Menaxheri ZP
Hamide Jashari